



Republika e Kosovës


Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Pushtetit Lokal

Ministarstvo Lokalne Samouprave

Ministry of Local Government



Për:	Haki Rugova, Kryetar i Komunës së Istogut Qaush Balaj, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut	
Kopje:	Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në MPL Njesisë për Administrimin e Dokumenteve në Komunë	
Përmes:	Goran Rakić, Zëvendëskryeministër dhe Ministër në MPL Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme në MPL	
Nga:	Venera Çerkini, Udhëheqës e Departamentit Ligjor dhe Monitorim të Komunave	Datë: 15.07.2020 Nr.020-501
Zyrtaret përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa, Udhëheqës i Divizionit për Monitorim të Komunave	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Sanije Dërguti, Zyrtare e lartë për monitorim të komunave	
Lënda:	Konfirmim i ligjshmërisë së aktit të Komunës së Istogut	
Lloji i aktit:	☐ Vendim i Kuvendit të Komunës	

I nderuar Kryetar,

I nderuar Kryesues,

Në pajtim me Rregulloren e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, e në bazë të kompetencave ligjore të ministrisë të përcaktuara me ligjet bazike dhe Rregulloren e Qeverisë Nr. 06/2020 për Fushat dhe Përgjegjësitë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, Departamenti Ligjor dhe Monitorim të Komunave i Ministrisë së Pushtetit Lokal ka pranuar për shqyrtim të detyrueshëm të ligjshmërisë ashtu siç parashihet me nenin 81 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale aktin komunal në vijim:


Vendimi 01 Nr.36/2020 për rishqyrtimin e vendimit me numër 01 Nr.14/2020 të datës 28 shkurt 2020 për dhënien në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës me negocim
I miratuar më datë: 30.06.2020
I parashtruar për shqyrtim në MPL më datë: 07.07.2020

Ministria e Pushtetit Lokal, pas shqyrtimit të përmbajtjes së aktit të komunës si më sipër, vlerëson se akti i komunës në aspektin procedural është në pajtim me dispozitat e legjislacionit në fuqi dhe si i tillë mund të prodhojë efekte juridike.

Ministria e Pushtetit Lokal mbetet në dispozicion të komunës për çfarëdo sqarimi të mëtejshëm në lidhje me këtë vlerësim.



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government



Za:	Haki Rugova, gradonačelnik opštine Istok Qaush Balaj, predsedavajući Skupštine opštine Istok	
Kopije:	Jedinici za administraciju dokumenata u MLS Jedinici za administraciju dokumenata u opštini	
Preko::	Goran Rakić, zamenik premijera i ministar MLS Rozafa Ukimeraj, generalna sekretarka MLS,	
Od:	Venera Çerkini, rukovodilac Pravnog odeljenja i monitorisanje opština /MLS	Dana, 15.07.2020 br.020-501
Odgovni službenici:		
1. Službenik-ca za potvrđivanje pravne procene:	Xhevat Tafa, rukovodilac Odseka za monitorisanje opština	
2. Službenik-ca za izradu pravne procene:	Sanije Dërguti, viša službenica za monitorisanje opština	
Predmet:	Potvrda o zakonitosti akta Skupštine opštine Istok	
Vrsta odluke:	☐ Odluka Skupštine opštine	

Uvaženi gradonačelnice,

Uvaženi predsedavajući,

U saglasnosti sa uredbom Vlade Republike Kosovo br. 10/2019 za administrativno razmatranje akata opštine, i na osnovu zakonskih ovlašćenja ministarstva određenim osnovnim zakonima i uredbom Vlade br. 06/2020 o oblastima i administrativnim odgovornostima Kancelarije premijera i ministarstva, Odeljenje za zakonska pitanja i monitorisanje opština MLS, primilo je za obavezno razmatranje zakonitosti kako je predviđeno članom 81. Zakona br. 03/L-40 o lokalnoj samoupravi opštinskog akta kao u nastavku:

Odluka 01 br.36/2020 o ponovnom razmatranju Odluke pod brojem 01 br.14/2020 od 28. februara 2020.godine, o davanju na dugoročno korišćenje nepokretne opštinske imovine uz pregovaranje

Usvojena dana, 30.06.2020.godine,

Predložena za razmatranje u MLS, dana, 07.07.2020.godine,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave, nakon razmatranja sadržaja gore navedenog akta opštine, procenjuje da je opštinski akt u proceduralnom aspektu u saglasnosti sa zakonskim odredbama zakonodavstva na snazi i kao takav može proizvesti pravni efekat.

Ministarstvo lokalne samouprave ostaje na raspolaganju opštini za dodatna objašnjenja u vezi sa ovom procenom.

Mbështjellësi I lëndës (akteve)

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO-OPSTRA ISTOK

Pranuar Pranimjens	27 11 2019		
Drejtorja Direktoja	Nr Sr	Shifra Prillog	Vlera Vendnost
01	016	53437	

Akti- lënda vendoset në a.a.

Shenja e klasifikimit _____

Lënda INOLF METAL SH.P.K. - SINAJE

Lëndët e zgjidhura njëkohësisht nr. _____

Numri I ruajtur dhe Afati I ruajtjes _____

Numri nga libri intern I dorëzimit _____

Afati

Data _____/_____/_____

Vendi _____

Zgjidhja e lëndës

Aprovim/ Refuzim

Përpunoi

KËRKESË

REPUBLIKAN E KOSOVES KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO - ISTOGUT

Numri i Dokumentit	27.11.2019		
Emri i Komunes	Pr. Idr	Numri i Dokumentit	Vendi i Dokumentit
01	016	534.37	

Për: Kryetarin e Komunës, z. Haki Rugova
Nga: Wolf Metal SH.P.K., pronari Ukë Blakaj

I nderuari Kryetar

Ne si kompani, me numër identifikues 811338799, veprimtarinë kryesore të biznesit e kemi parafabrikimin e mureve të shtëpive nga druri.

Me qëllim të zhvillimit ekonomik

Kërkojmë nga komuna e Istogut që të na japë në shfrytëzim pronat komunale, përkatësisht Njësiti Kadastrale P-70806014-00099-11 me sipërfaqe prej 19341 m² dhe Njësiti Kadastrale P-70806014-00099-12 me sipërfaqe prej 6570 m², me sipërfaqe të përgjithshme për të dy Njësiti Kadastrale prej 25,911 m², P.SH.SH- Komuna Istog, Zona Kadastrale në Dubravë, me qëllim të ndërtimit të objekteve dhe zhvillimit të aktivitetit biznesor.

Vlera e përafërt e investimit në këtë biznes është dikur rreth 1,000.000 € (një milion euro).

Kërkesën tonë e mbështesim në Ligjin 06/L-092 për dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës.

Mbështjellësi i lëndës (akteve)

REPUBLIKA E KOSOVES-KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVO-OPSTINA ISTOK

Prenuar Pranijeno	13.02.2020		
Drejtori Drejtoresha	Nr. Sr.	Shënime Përmirësim	Vlera Vlerësimet
01	941	5970	

Akti- lënda vendoset në a.a.

Shenja e klasifikimit _____

Lënda WOLF METAL SH.P.K. - SHINAJE

Lëndët zgjidhura njëkohësisht nr. _____

Numri i ruajtur dhe Afati i ruajtjes _____

Numri nga libri intern i dorëzimit _____

Afati

Zgjidhja e lëndës

Aprovim/ Refuzim

Data _____/_____/_____

Vendi _____

Përpunoi _____

KËRKESË

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E ISTOGUT
REPUBLIKA KOSOVA GJISTINA ISTOK

Data e pranimit			
13.02.2020			
Organizimi Drejtoria	nr. 11	Shifra e Pranimit	Vlera Vendoset
01	941	5970	

Për: Kryetarin e Komunës, z.Haki Rugova

Nga: Wolf Metal Sh.P.K., pronari Ukë Blakaj

I nderuari Kryetar

Duke i referuar kërkesës se dt.27.11.2019 me nr.01-016-53437 dhe pas Negocimit të ofertave që kemi bërë me Kryetarin e Komunës dhe me qëllim të zhvillimit ekonomik pasi që veprimtarinë kryesore të biznesit e kemi parafabrikimin e mureve të shtëpive nga druri me qrast kemi kërkuar nga komuna e Istogut që të na jep në shfrytëzim pronën komunale të cekur në kërkesën e përmendur më lartë bëjmë korigjimin e parceles dhe kërkojm njësin kadastrale P-70806044-00211-7 që ndodhet ne ZK.Sinajë P.SH. E MIR E FSHATIT me sipërfaqe prej 9936m², me qëllim të ndërtimit të objekteve dhe zhvillimin e aktivitetit biznesor.

Vlera e përafert e investimit në këtë biznes është diku rreth 1,000,000.00€ (një milion euro)

Kërkesën tonë e mbështesim në Ligjin 06/L-092 për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së palujtshme të Komunës.

Kësaj kërkesë i bashkangjes edhe :

- Plani i Biznesit WOLF METAL SH.P.K
- Projekti ideor WOLF METAL SH.P.K
- Çertifikaten e regjistrimit të biznesit
- Fletën poseduese dhe Kopjen e Planit
- Orto foto nga gjeo portali shtetror.



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipal of Istog


Më: 01.07.2020

OFERTA E NEGOCIUAR - WOLF METAL

Gjatë takimeve të realizuara në mes të investitorit Ukë Blakaj, drejtor i kompanisë "WOLF METAL" SHPK me Kryetarin e Komunës, z. Haki Rugova për marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim, në Zonën Industriale të Istogut përmes negocimit me qëllim të investimit ashtu siç parashihet ligjërisht në Ligjin Nr. 06/L-092 mbi Dhënie në Shfrytëzim të Pronës së Paluajtshme të Komunës, u negociua oferta me pika kryesore të saj si në vijim të cilat më gjerësisht janë paraparë në planin ideor për investim:

- Planifikimi i investimit dhe zgjerimit të biznesit me qëllim të kryerjes së punëve lidhur me parafabrikimin e mureve të shtëpive nga druri ku vlera e përgjithshme e investimeve në këtë projekt do të jetë 1,000,000€ - 1,200,000 € (një milion deri një milion e dyqindmijë euro).
- Prodhimi i mureve të brendshme të shtëpive do të jetë për fillim pastaj do të zgjerohet aktiviteti i prodhimit;
- Objekti i cili do të realizohet do të jetë me sipërfaqe prej 3000 m² me hapësirë përcjellëse prej 5000 m²;
- Gjenerimi i vendeve të reja të punës ku fillimisht do të ketë 60 të punësuar
- Planifikimi që brenda 2 vitesh të arrihet numri i të punësuarve deri në 90 persona

Investitori,
Ukë Blakaj



Kryetari i Komunës,
Haki Rugova



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipal of Istog

Nr. 31/2020
Më: 22.01.2020

Procesverbal nga takimi i parë për shqyrtimin e ofertës së negocimit nga WOLF METAL

Investitori Ukë Blakaj, drejtor i kompanisë WOLF METAL SHPK më 27.11.2019 parashtoi kërkesën Nr.01-016-53437 drejtuar Kryetarit të Komunës, z. Haki Rugova marrjen e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim përmes negocimit me qëllim të investimit ashtu siç parashihet ligjërisht në Ligjin mbi Dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës, Njësine Kadastrale 211-7, Zona Kadastrale në Sinajë.

Pas pranimit të kërkesës lidhur me këtë qëllim negociatat kanë filluar më 22.01.2020 ku realizohet takimi i parë ndërmjet Kryetarit të Komunës, z. Haki Rugova dhe investitorit, Ukë Blakaj, ku prezent ishin edhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Lulzim Blakaj, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor Besart Dreshaj dhe Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi Jashar Blakaj.

Investitori para kryetarit të komunës prezantoi planin e biznesit dhe projektin ideor me qëllim të marrjes së shfrytëzimit të pronës së paluajtshme të komunës përmes negocimit. Gjatë bisedës me kryetarin investitori e informoi atë se qëllimi i hapjes së kësaj fabrike është parafabrikimi i mureve të shtëpive nga druri ku prodhimet do të tregtohen në Gjermani, Shqipëri, Maqedoni të Veriut dhe Kosovës, me një objekt prej 3000 m² me hapësirë të objektit përcjellës 5000 m² ku fillimisht do të jenë 60 të punësuar dhe vlera e investimit rreth 1.000.000 deri në 1.200.000 € (një milion deri në një milion e dyqind mijë euro).

Pas prezantimit të planit ideor dhe atij të biznesit nga ana e investitorit u pajtuan me kryetarin e komunës që të zhvillohen prapë takime tjera si dhe investitori të parashtojë një kërkesë të re të kompletuar me të gjithë dokumentacionin përcjellës.

Zyrtari Ligjor,
Faton Bujupi


Procesmbajtës



Kryetari i Komunës,
Haki Rugova





Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republie of Kosovo



Komuna e Istog
Opština Istok
Municipal of Istog

Nr. 45/2020
Më: 14.02.2020

Procesverbal nga takimi i dytë për shqyrtimin e ofertës së negocimit nga WOLF METAL

Pas parashtrimit të kërkesës së parë më 27.11.2019 me Nr.01-016-53437 nga ana e investitorit Ukë Blakaj, përfaqësues i kompanisë WOLF METAL SHP dhe realizimit të takimit me Kryetarin e Komunës z. Haki Rugova, investitori parashtroi kërkesën e dytë Nr. 01-941-5970 më 13.02.2020 me të njëjtin qëllim sikurse në kërkesën e parë, marrjen në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës me qëllim të investimit, respektivisht hapjes së fabrikës për parafabrikimin e mureve të shtëpive të drurit.

Pas pranimit të kërkesës së dytë u realizua takimi i dytë më 14.02.2020 në mes të investitorit Ukë Blakaj dhe Kryetarin e Komunës z. Haki Rugova me qëllim të finalizimit të bisedimeve për ofrimin nga ana e komunës pronën e paluajtshme për shfrytëzim me qëllim të investimit ashtu siç ishte prezantuar nga plani ideor në takimin e parë.

Në takimin e dytë u konfirmuan të gjitha ato tema që ishin diskutuar nga takimi parë pa asnjë ndryshim dhe u arrit pajtimi që të procedohet më tutje kjo kërkesë, respektivisht të prezantohet për miratim në seancën e kuvendit të muajit shkurt të vitit 2020.

Po ashtu sikurse edhe në herën e parë në këtë takim ishin prezentë edhe Drejtori i Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik Lulzim Blakaj, Drejtori i Drejtorisë për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor Besart Dreshaj dhe Drejtori i Drejtorisë për Kadastër dhe Gjeodezi Jashar Blakaj.

Zyrtari Ligjor,
Faton Bujupi


Procesmbajtës






Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

KUVENDI I KOMUNËS
SKUPŠTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01 NR.30/2020

Data:
30.06.2020



Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika 1) dhe 51 të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr 28/2008) dhe në pajtim me nenin 33 Paragrafi 33.1 pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. Dhe në bazë të nenit 6 paragrafi 1.2 si dhe nenit 11 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 10/03) , në mbledhjen e mbajtur më 30.06.2020, shqyrtoi dhe miratoi Rishqyrtimin e Vendimeve 01NR 13/2020 të datës 28.02.2020 dhe 01NR 14/2020 për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë përmes negocimit, dhe mori këtë:

V E N D I M

RISHQYRTOHEN VENDIMET E KUVENDIT ME NUMËR 01NR.13/2020 DHE
VENDIMI 01NR.14/2020 TË DATËS: 28.02.2020 PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM
AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS ME NEGOCIM

1. Kuvendi i komunës shqyrtoi kërkesën e MAPL-së të datës 22.06.2020 që ka të bëjë me Rishqyrtimin e Vendimeve të Kuvendit të Komunës
 - Vendim 01Nr 13/2020 të datës 28.02.2020 për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë (30 vite) me negocim, Gurrakoc,
 - Vendim 01Nr.14/2020 të datës 28.02.2020 për dhënie e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë (30 vite) me negocim, Sinajë.

Dhe autorizohen ekzekutivin e komunës për plotësimin, përkatesisht, dërgimin e dokumentacionit plotësues sipas kërkesës së cekur me lartë të MAPL-së
2. Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Shërbimi pronëso-ro-juridik në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër
3. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjete) dite pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) dite pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, Kryetari i Komunës, Shërbimi pronëso-ro-juridik në Drejtorinë për Gjeodezi dhe Kadastër, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.



TEKSTI I KËTJË DOKUMENTI ËSHTË
PËR PËRBLIDHJE PËR QYLLIN E SHËRBUJES
DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËR VETËQEVERISJE
E PUNËVE OPŠTINE E ISTOGUT

Nr. 01/069 30 Data 07.07.2020


ISTOG-ISTOK



KRYESUESI I KUVENDIT,

Qush Balaj

[Signature]




Republika e Kosovës
Republika Kosovo
Republic of Kosovo

KUVENDI I KOMUNES
SKUPSTINA OPŠTINE
MUNICIPAL ASSEMBLY

01 Br.36/2020

Datum:
30.06.2020

Komuna e Istogut
Opština Istok
Municipality of Istog



Skupština opštine, u skladu sa članom 12 stav 12.2 tačka d) i član 40 stav 40.2 tačka 1) Zakona o lokalnoj samoupravi br. 03/L-040 (Službeni glasnik Republike Kosovo, br. 28/2008) i u skladu sa članom 33 Stav 33.1. tačka 11) Statuta Opštine 01 Broj 62/10 i u skladu sa članom 6. stav 1.2 kao i članom 11 Zakona o eksploataciju i Razmeni Nepokretne Opštinske Imovine Br 6/L-092 (Službeni glasnik Republike Kosovo br. 10/03), na sednici održanoj u. 30.06.2020, razmotrila i odobrila ponovni Pregled odluke 01Br.13/2020 od 28.02.2020 i 01Br.14/2020 za davanje na korišćenje opštinske imovine uz dugoročno pregovaranje, i donese ovu:

ODLUKU

PREISPITUJU SE ODLUKE SKUPŠTINE: 01BR.13/2020 od 28.02.2020 I ODLUKA 01BR.14/2020 ZA DAVANJE NA DUGOROČNO KORIŠĆENJE OPŠTINSKE NEPOKRETNOSTI IMOVINE UZ PREGOVARANJE

1. Skupština opštine razmatrala je zahtev MALS-a od 22.06.2020, što se odnosi na preispitivanje odluka Skupštine Opštine:
 - Odluka 01Br.13/2020 od 28.02.2020 za davanje na korišćenju opštinske imovine uz dugoročno pregovaranje za 30 godina, Đurakovac,
 - Odluka 01Br.14/2020 od 28.02.2020 za davanje na korišćenju opštinske imovine uz dugoročno pregovaranje za (30 godina), Sinja.
 i ovlašćuje izvisna vlast Opštine da doveri slanje dodatne dokumentacije prema gore navedenom zahtevu MALS-a.
2. Za provedbu ove Odluke pobrinut će se Imovinsko - pravna služba u Direkciji za Geodeziju i Katastar.
3. Ova Odluka stupa na snagu 15 (petnaest) dana nakon registracije u protokolarnom uredu Ministarstva nadležnog za lokalnu samoupravu, kao i 7 (sedam) dana od dana objavljivanja na službenoj web stranici Opštine.

Kopije ove Odluke dostavljaju se gradonačelniku, Ministarstvu Lokalne Samouprave, Katastar i Geodeziju, Direkciji za Urbanizam i Okolišno planiranje, Direkciji za Ekonomski Razvoj i Direkciji Inspekcije, a primerak ostaje u arhivi Skupštine.

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA E ISTOGUT
OPŠTINA ISTOK
MUNICIPALITY OF ISTOG
MUNICIPAL ASSEMBLY

01-035-30
Data: 02.07.2020
Datum:



 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.14/2020	Data: 28.02.2020	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe neni 40 paragrafi 40.2 pika I) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr 03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 11) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. Dhe në bazë të nenit 6 paragrafi 1.2 si dhe nenit 11 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr 10/03), në mbledhjen e mbajtur më: 28.02.2020, shqyrtoi Propozim - Vendimin e Kryetarit të Komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale me negocim afatgjatë, dhe mori:


V E N D I M PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Miratohet Propozim - Vendimi i kryetarit të komunës për dhënie në shfrytëzim të pronës komunale me negocim afatgjatë dhe -Njësia Kadastrale Nr. 211-7, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9939 m², Zona Kadastrale Sinajë, e evidentuar sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 140/2020 e datës 12.02.2020 si P.S.H. e mirë e fshatit (në vendin e quajtur "Rudesh") i ipet investitorit "WOLF METAL" SHPK, me pronarin z. Ukë Blakaj nga Istogu, me çmim në lartësi prej 600 € në vit,
2. Afati kohor për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme është (tridhjetë) 30 vite.
3. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas projekt të propozuar nga investitori.
4. Autorizohet kryetari i komunës në përputhje me këtë vendim të lidhë marrëveshje me investitorin me të cilin me për se afërmido të përcaktohen, kushtet dhe kriteret për shfrytëzimin të paluajtshmerisë së cekur në piken I të këtij vendimi për shfrytëzim dhe implementim e këtij projekti të cilit i është dhënë kjo pronë.
5. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.
6. Ky Vendim hynë në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë përgjegjëse për Vetëqeverisje Lokale, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit të tij në faqen zyrtare të Komunës.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion, dhe një kopje mbetet në arkivin e Kuvendit.

REPUBLIKA E KOSOVES KOMUNA E ISTOGUT
 REPUBLIKA KOSOVO OPŠTINA ISTOK
 DREJTORIA E ADMINISTRATËS PËRGJITHSHME
 UPRAVA OPŠTE ADMINISTRACIJE

Udhëzimi
 Nr. 01-039-16 Data 6-03-2020
 Br. Datum
 ISTOG-ISTOK

KRYESUESI I KUVENDIT,
 Qaush Balaj


 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KRYETARI I KOMUNËS PREDSEDNIK OPŠTINE MUNICIPAL MAYOR		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.45/2020	Data: 18.02.2020	

Kryetari i Komunës, bazuar në nenin 58, pika (h), nenin 12 dhe 14 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, publikuar në (Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenin 11 të Ligjit për Dhënie në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr. 06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10/2019) dhe nenin 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010 për dhënie në shfrytëzim afatgjatë pronën e paluajtshme të komunës, Njësine Kadastrale Nr. 211-7, Zona Kadastrale në Sinajë, investitorit "WOLF METAL" SHPK me pronar Ukë Blakaj, pas negociatave të zhvilluara në mes të Kryetarit të Komunës dhe investitorit Ukë Blakaj "WOLF METAL" SHPK, Kryetari i Komunës i propozon Kuvendit të Komunës që në seancën e mbajtur më ___/02/2020 të miratojë këtë:

P R O P O Z I M - V E N D I M

PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS

1. Sipas këtij Propozim-Vendimi t'i jepet në shfrytëzim afatgjatë (30 vite) investitorit "WOLF METAL" SHPK, me seli në Sinajë, prona e paluajtshme e komunës, Njësia Kadastrale Nr. 211-7, me sipërfaqe të përgjithshme prej 9939 m², me çmimin vjetor prej 600 €, në vendin e quajtur "Rudesh" Zona Industriale, Zona Kadastrale Sinajë e cila sipas certifikatës pronësore me numër të referencës 140/2020 e datës 12.02.2020 është e evidentuar P.SH. E MIRË E FSHATIT.
2. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës është zhvillimi i aktiviteteve biznesore si dhe gjenerimi i vendeve të reja të punës sipas standardeve të përcaktuara me dispozitat ligjore.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi kujdeset Zyra e Kryetarit, Drejtoria për Kadastër dhe Gjeodezi, Drejtoria për Planifikim Urban dhe Mjedis, Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim dhe Drejtoria për Inspektion.
4. Ky Vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Administratës Publike si dhe publikimit në gjuhë zyrtare në uebfaqe të Komunës.

Arsyetim

Baza ligjore për miratimin e këtij Propozim-Vendimi është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 dhe nenit 83 të Statutit të Komunës së Istogut 01 Nr.62/2010.

Kryetari i Komunës duke u bazuar në nenin 11 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbimin e Pronës së Paluajtshme të Komunës Nr.06/L-092 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.10/2019) sipas autorizimeve ligjore që ka fillimisht ka realizuar negociata të vazhdueshme me investitorin Ukë Blakaj " WOLF METAL " SHPK dhe Bordit të Drejtorëve ua ka prezantuar kërkesat e investitorit, kërkesën Nr.01-016-53437 të datës 27.11.2019 dhe kërkesën 01-941-5970 të datës 13.02.2020 me dokumentet tjera përcjellëse (planin ideor, planin e biznesit, certifikatën e regjistrimit të biznesit etj).

Sipas projektit ideor dhe sipas negociatave investitori planifikon që në njësinë e lartcekur hap biznesin afarist-prodhues, përkatësisht të bëjë parafabrikimin e mureve të shtëpive nga druri ku vlera e përgjithshme e investimeve në këtë projekt do të jetë 1.000.000€ - 1.200.000€. Objekti i cili do të realizohet do të jetë me sipërfaqe prej 3000 m², me hapësirë përcjellëse prej 5000 m². Përveç rritjes së vlerës së Pronës së paluajtshme të Komunës sipas projektit ideor do të gjenerohen edhe vende të reja të punës ku fillimisht do të ketë 60 të punësuar dhe përparësi do të kenë banorët e Komunës së Istogut.

Me qëllim të realizimit të interesit publik, rritjes së vlerës së pronës publike komunale, krijimit të të hyrave vetanake në njërën anë dhe ofrimit të kushteve për krijimin e vendeve të reja të punës në anën tjetër përmes bërjes së politikave të punësimit, propozohet dhënia në shfrytëzim e pronës së paluajtshme të Komunës investitorit të lartcekur siç përcaktohet në nenin 1 të këtij propozim-Vendimi andaj kërkojmë nga Kuvendi i Komunës miratimin e këtij Propozim-Vendimi.



Kryetari i Komunës,
Haki Rugova


PROJEKTI IDEOR





OBJEKT AFARIST HALLË PRODHUESE - INDUSTRIALE


Investitor: "WOLF"
Pronar: UKË BLAKAJ


Nëntor 2019, Istog.

KOMPLEKSI INDUSTRIAL "Wolf Group"



[illegible][illegible]

[illegible]



	
Ministria e Arsimit dhe Shkencave Republika e Shqipërisë	
PROJEKTI GJERGJ ARHITEKTURA	
Titulli i Projektit: HALLA PRODHUESE Sipërfaqja: 1,248.68 m²	
Autori: Ing. G. GJERGJ Viti: 2000	
Pajisje: HALLA E PRODHUESE Baza e Hallës Prodhuese	
Skala: 1:100	
Data: 01/2000	
A. G.	

PLAN BIZNESI

KOMPANIA:

WOLF METAL SH.P.K

PLAN BIZNESI

WOLF METAL Shpk si kompani e cila veprimtari kryesore e ka biznesin e parafabrikimin e mureve te shtëpive nga druri , ka paraparë një qasje më tjetër në zhvillimin e biznesit të vet. Kështu që, pas analizave të shumta të bëra, janë përcaktuar vizioni dhe misioni i kësaj kompanie për zhvillimin e biznesit në të ardhmen.

Vizioni

Të jemi pjesëmarrës në industrinë për përpunimin e parafabrikeve te mureve te shtëpive nga druri , pjesëmarrës ne tregun brenda vendit dhe jashtë vendit në rritje të vazhdueshme për t'u zgjeruar në rajon si dhe me shërbime konkurruese, komode dhe me saktësi të lartë. Me qëndrueshmëri financiare dhe ngritje të vazhdueshme ku puna jonë të jetë burim i vazhdueshëm i besueshmërisë së klientëve tanë dhe krenarisë për ne.

Misioni

Të jemi bartës të zhvillimit ekonomik të vendit duke ofruar zgjedhje konkurruese të prodhimit dhe me punën tonë të përmirësojmë mirëqenien e qytetarëve tanë.

Ndërmarrja

Ndërmarrja Wolf metal sh.p.k. do të filloj aktivitetin e vet si fillim në fushën e prodhimit te parafabrikeve për ndërtimin e shtëpive. Kjo kompani është shoqëri me përgjegjesi te kufizuar dhe ka si capital te investuar nga nje pronar investimet fillestare janë nga puna e me hershme .

Ndërmarrja funksionon me keto kapacitete :

Objektin me siperfaqe prej 3000 m² me nje hapsire percjellese prej 5000 m² .

Makineria është per e gabariteve te mëdha dhe i gjithë prodhimi është i kompjuterizuar ne vije te caktuar. Sistemi i punës në makineri eshte i tillë që gjatë punës nuk ka kontakt me personeli por është i automatizuar me CNC .

Objektivat

Me fillimin e prodhimit si prodhim do të kemi muret e brendshme të shtëpive, prodhimet e para do të jenë në tregun Gjerman nga se kemi bashkëpunim me kompaninë WOLF GMBH dhe WOLF MONTAGEBAU që prodhimet të tregtohen nga kjo kompani. Numri fillestar i të punësuarve do të jetë 60 të punësuar të profileve të ndryshme.

Në vitin e dytë do të zgjerohet dhe me makineri tjetër që do të jetë parafabrikimi i mureve tjera dhe kulmit që të rrisim numrin në të punësuarve nga Komuna e Istogut dhe me gjere.

Objektivi kryesor do të jetë që të fitojmë një vend tek konsumatorët dhe besimin e tyre.

Strategjia për arritjen e objektivave

Në mënyrë që të arrijmë objektivat e lartcekura ne kemi kombinuar disa strategji në mënyrë që rezultati të jetë më i mirë dhe më lehtë i matshëm. Në mënyrë që të arrijmë rritjet e parapara ekonomike qoftë në prodhim dhe ngritje të kapacitete prodhuese, rritjen e makinerisë prodhuese dhe të mjeteve lëvizëse, ne kemi zgjedhur strategjitë e marketingut adekuate për llojin e shërbimeve dhe nevojat e ndryshme që kanë konsumatorët.

Ne do të përdorim këto strategji :

Strategjinë zgjeruese, ku do të orientohemi drejt konsumatorëve të rregullt;

Strategjinë depërtuese/zgjeruese, në drejtim të konsumatorëve potencialë si dhe

Strategjinë sulmuese, në drejtim të konsumatorëve të ri.

Ndërsa sa i përket realizimit të objektivave qasja jonë do të jetë e fokusuar në:

- Kontrollin e kualitetit të punëve karshi rregulloreve dhe standardeve adekuate;
- Aplikimin e teknologjisë informative dhe digitalizimin e proceseve të punës;
- Aplikimin e sistemit të shpërblimit dhe ndëshkimit karshi performancës së treguar;
- Shkollimin dhe trajnimet e stafit karshi zhvillimit të fushave përkatëse dhe
- Punësime të reja.

Burimet e nevojshme

- Burimet tekniko-teknologjike;

- Burimet njerëzore dhe
- Burimet financiare që në të njëjtën kohë i mbulon edhe dy burimet e lartpërmendura

Procesi tekniko-teknologjike

Ne fillim te procesit lendet nga druri futen ne makinën për transporter që kalon në proces të përpunimit i gjithë procesi është i digjitalizuar dhe për çdo prodhim përgaditet projekti nga arkitektet dhe inxhinjeret .Pas përpunimit procesi kalon në montim që është një proces teknologjik gjysëm automatik, në montim marrin pjesë një numër i aktuar i punëtorëve, pas montimit procesi kalon në mveshje e mureve me material izolues montimi i dritareve ,dyerve ,procesi kalon në fasadim dhe muret janë të gatshme për montim në vend përfundim.

Burimet njerëzore

